



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:234387

Datë: 24.11.2023

Numri i dokumentit: 04968275

NE ËMËR TE POPULLIT

P.nr.162/17

GJYKATA THEMELORE PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnya në çështjen penale kundër të pandehurit M. K. nga Peja, për shkak të veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.205/17 të datës 14.02.2017, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 02.11.2023, në prezencë të Prokurorit të shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit M. K., në të njëjtën datë shpalli ndërsa me datë 20.11.2023 përpiloi këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri:

M. K. , nga i ati B. dhe nena Gj., e vajzërisë Gj., i lindur me dt., ne Peje, me vendbanim ne Fushën e Pejës, (ne afërsi te Fabrikës G.), ka te kryer shkollën e mesme, me profesion bujk , i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar babi i dy fëmijë, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 par.1 pika 1.1 te KPRK-së,

I. LIROHET NGA AKUZA

Për shkak se :

Qe nga viti 2014 e ne vazhdim, në fshatin G. Komuna e Pejës, me dashje dhe në menyrë të kundërligjshme e ka uzurpuar pronën e paluajtshme të të dëmtuarve B. J. dhe J. Jokiç, në atë menyrë qe i pandehuri me keqbesim ka blerë patundshmerinë me numer të njësisë kadastrale P-.....-...../3 me sipërfaqe prej 12.10 m², nga D. M. edhe pse i njëjti nuk i kishte dhënë në shikim të pandehuarit as autorizim e as dokumentacion të kësaj patundshmerie lëndore, të cilën i njëjti e

ka rrethuar dhe të njëjtën e shfrytëzon dhe nuk pranon ta liroj edhe pse të dëmtuarat e kërkojnë një gjë të tillë.

-me çka kishte për të kryer veprën penale Uzurpim i paligjshme i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-se (04-L/082) .

II. Shpenzimet e procedurës mbeten në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga të dëmtuarit.

ARSYETIM

a) Historiku i çështjes;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithëshëm pranë kësaj gjykatë ka parqitur aktakuzën PP/II.nr.205/2017 të datës 14.02.2017, kundër të pandehurit M. K. për shkak të veprës penale Uzurpim i paligjshme i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se (04/L-082).

Gjykatat e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale me datë 02.11.2023, në të cilat seanca prezentuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri M. K., ndërsa s ai përket të dëmtuarve gjykata u ka derguar thirrje dhe ka kërkuar verifikim adrese përmes policisë, mirëpo rezulton se të njëjtat jetojnë në Serbi.

b) Faktet e çështjes (pretendimet e akuzës) ;

Prokurori i Shtetit në aktakuzë pretendon se i pandehuri M. K. nga viti 2014 e në vazhdim, në fshatin G. Komuna e Pejës, me dashje dhe në mënyrë të kundërligjshme e ka uzurpuar pronën e paluajtshme të të dëmtuarve B.J. dhe J. J., në atë mënyrë që i pandehuri me keqbesim ka blerë patundshmerinë me numer të njësisë kadastrale P-.....-...../3 me sipërfaqe prej 12.10 m², nga D. M. edhe pse i njëjti nuk i kishte dhënë në shikim të pandehurit as autorizim e as dokumentacion të kësaj patundshmerie lëndore, të cilën i njëjti e ka rrethuar dhe të njëjtën e shfrytëzon dhe nuk pranon ta liroj edhe pse të dëmtuarat e kërkojnë një gjë të tillë.

Nga ky përshkrim shihet se prokuroria ka renditur faktet mbi bazën e të cilave e akuzon të pandehurin se e ka uzurpuar pronën e të dëmtuarëve të përshkruara si në dispozitiv të këtij

aktgjykimi, duke paraqitur si veprim te kryerjes faktin se i pandehuri me keqbesim e ka blerë parcelën kontestuese te cilën edhe e ka rrethuar dhe e shfrytëzon.

c) Baza ligjore (Vepra penale me të cilën ngarkohet i pandehuri);

I pandehuri akuzohet se ka kryer veprën penale Uzurpim i paligjshme i pronës se paluajtshme nga neni 332 par.1 te KPRK-se (04/L-082), e cila vepër e ka këtë përshkrim:

“ Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet”.

Për tu kryer kjo vepër penale kërkohet qe kryerësi i kësaj vepre penale te hy ne posedim te pronës se paluajtshme te personit tjetër duke e pushtuar te njëjtën dhe se në momentin e hyrjes në posedim, te jetë i vetëdijshëm se nuk ka një pëlqim nga personi i tillë dhe se hyrja në posedim behet në mënyrë të kundërligjshme pa pasur ndonjë bazë.

E rëndësishme të kjo vepër penale është:

- Veprimi i hyrjes në posedim-pushtimi, si element objektiv i veprës penale dhe
- Dijenia se nuk ka bazë apo pëlqim nga personi tjetër (poseduesi i ligjshëm), si element subjektiv i kësaj vepre penale.

Të kjo vepër penale kërkohet qe kryerësi i veprës penale të jetë i vetëdijshëm se është duke pushtuar pronën e paluajtshëm te personit tjetër dhe se një gjë të tillë është duke e bërë në mënyrë të kundërligjshëm, pa ndonjë bazë juridike në të cilën mbështet pretendimet për marrjen e kontrollit në pronën e pa luajtshme.

Dihet se mbrojtja e pronësisë në parim bëhet përmes padisë në procedurë kontetsimore dhe atë deri ne momentet kur veprimet e penguesit ose privuesit nga posedimi nuk kanë karakter penalo juridik.

Veprimet e penguesit ne raport me pronën e tjetrit marrin karakter penalo juridik në momentin kur kryerësi me dashje pushton pronën e tjetrit pa pasur ndonjë bazë pronësore, ndërsa në rastet tjera kur veprimet e kryerësit në raport me pronën e personit tjetër bazohen në një pretendim të

caktuar pronësor, kjo situatë ka karakter juridiko-civil dhe duhet të marr mbrojtje në procedurë kontetsimore përmes padisë për pengim posedim më të cilën kërkohet kthimi i posedimit ose padisë pronësore me të cilën kërkohet lirimi i pronës.

Gjithashtu, është me rëndësi të thuhet se personi i cili e ka vendosur posedimin në mënyrë të ligjshme, edhe nëse ndërkohë e humbet bazën e posedimit, nuk mund të konsiderohet uzurpator apo pushtues i asaj paluajtshmerie, pasi që pushtimi kryhet me një akt apo veprim që ndërmerret në momentin e vendosjes së pushtetit faktik mbi paluajtshmerinë e tjetrit.

Pra si përfundim, ligjvënësi më këtë veper ka inkriminuar aspektin subjektiv, përkatësisht dijeninë e të pandehurit se është duke pushtuar paluajtshmerinë e tjetrit pa asnjë bazë ligjore.

d) Provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, vlerësimi dhe çmuarja e tyre;

Gjatë shqyrtimit gjyqësor para kësaj gjykata u administruan provat materiale dhe u lexuan deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga prokurori i shtetit, e e që janë dëshmitarët Millutin Jokiç dhe Radmilla Peshut.

Gjithashtu u administruan provat materiale si në vijim: Kopja planit e parcelës .. dt.20.janar.2017, Certifikata pronës me nr..... dhe, e para në emër të J. B., ndërsa e dyta në emër të J. J., Kopja planit me nr.. e dt.17.05.1985, Kopja planit e par...., certifikata e pronës e parc...., kontrata mbi shitblerje të paluajtshmerisë lidhur në mes të S. D. dhe F. K. për parcelën ..., katër deklaratat të shkruara me dorë dhe të nënshkruara nga D. M. dhe M. K., në të cilën konstatohet vlera e pagesave të bëra në emër të shitblerës së parcelës, dhe Deklarata e noterizuar e dt.18.05.2023, nga e dëmtuara Jo. J., në të cilën thuhet se heq dorë nga ndjekja penale ndaj të pandehurit M. K..

Me qenë se edhe pas disa tentimeve gjykata nuk mundi të siguroj prezencën dëshmitarëve M. J. dhe R. P., në kuptim të nenit 335 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së pas marrjes së pajtimit të palëve u vendos që të lexohen deklaratat e tyre të dhëna në Stacionin Policor që të dyja me datë 18.01.2017.

Dëshmitari J. M. në polici kishte deklaruar “Me rastin e vizitës time në G. me datën 25.12.2016 kur kishte vdekur babai im V., motra ime R. P. me ka thënë se ka vërejtur se dikush e kishte

rrethuar një pjesë të patundshmërisë tonë. Në rastin konkret kam kuptuar se këtë pjese të tokës e kishte shitur D. M. në bazë të autorizimit të lëshuar nga S. dhe R. D.. D. jeton në G., D. jetojnë në Serbi ose në Mal të Zi. Konsideroj se autorizimi është dhënë në mënyrë të kundërligjshme dhe me këtë rast është uzurpuar prona jonë, këtë fakt e bazoj në kopjen e fletës poseduese ku shihet se pjesa e tokës së uzurpuar është në emër të J. J. dhe J. B., ndërsa parcela lëndore është evidentuar me numër ../3.

Me anë të kësaj deklarate nuk vërtetohet nëse i pandehuri M. K. është në posedim të parcelës kontestuese, e aq më tepër nuk përshkruhet se kush është në posedim të kësaj parcele dhe si e ka fituar posedimin e tillë, por përmes kësaj dëshmie dëshmitari vetëm e ngrit pretendimin se autorizimi i shitblerjes së parcelës kontestuese është i pavlefshëm.

Dëshmitarja R. P. në polici kishte deklaruar “ Përderisa isha në vizitë tek babi im Vido, diku më 20 Dhjetor, kam vërejtur se një pjesë e tokës tonë ishte uzurpuar dhe ishte rrethuar, fillimisht nuk e kam ditur se çka ka ndodhur , por kur ka ardhur vëllai im M. nga Gjermania , unë i kam treguar se çka ka ndodhur, ashtu që me vonë më ka treguar se token tonë e kishte shitur D. M., ku më pas e kemi lajmëruar policinë. Kjo është toka jonë që mund të vërtetohet edhe me listën poseduese ku në të shihet se toka është në emër të J. J. dhe J. B..

Gjithashtu edhe përmes dëshmisë së kësaj dëshmitare nuk vërtetohet se kush është poseduesi momental i kësaj parcele, e njëjtë tregon se kjo tokë është shitur nga D. M., por nuk tregon se kujt ja ka shitur, aq më tepër përmes dëshmisë së kësaj dëshmitare nuk vërtetohet nëse parcelën kontestuese e ka në posedim i pandehuri M. K. e aq më tepër nuk tregon nëse ka njohuri për mënyrën e hyrjes në posedim.

Me provat e emërtuara Kopja planit e parcelës ../3 e dt.20 Janar.2017, Certifikata pronës me nr....-16 dhe, e para në emër të J. B., ndërsa e dyta në emër të J. J., Kopja planit me nr.42 e dt.17.05.1985, Kopja planit e par../3, janë dokumente që vërtetojnë që parcela kontestuese figuron e regjistruar në pronësi të J. J. dhe J. B. gjë që nuk është fare kontestuese në këtë çështje penale.

Kontrata mbi shitblerje të palujtëshmërisë lidhur në mes të S. D. dhe F. K. për parcelën ../3, provë e propozuar dhe e dorëzuar nga këtu i pandehuri, më anë të cilës nuk vërtetohet ndonjë fakt

relevant, por qe sipas deklarimit të të pandehurit kjo parcelë ../3 është parcelë në kufi më parcelën kontestuese ../3, dhe se sipas të pandehurit i njëjti i ka blerë të dy parcelat nga D. M..

Katër deklarata të shkruara me dorë dhe të nënshkruara nga D. M. dhe M. K., në të cilën konstatohet vlera e pagesave të bëra në emër të shitblerës së parcelës kontestuese dhe parcelës tjetër ../3, paraqesin përshkrime të shumëvëra të ndryshme të cilat pretendohet se janë paguar në emër të shitblerjes së parcelës kontestuese.

Deklarata e noterizuar e dt.18.05.2023, nga e dëmtuara J. J., në të cilën thuhet se heq dorë nga ndjekja penale ndaj të pandehurit M. K., kjo është një deklaratë e nënshkruar nga e dëmtuara J. e vërtetuar tek noteri dhe përmes kësaj deklarate shihet se e dëmtuara nuk ka interes për ndjekjen penale të këtu të pandehurit.

I pandehuri M. K. në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë deklaroi se nuk e ka uzurpuar atë tokë, por se te njëjtën e ka blerë nga D. M., këtë parcele nuk e ka punuar asnjëherë dhe nuk e shfrytëzon, mirëpo të njëjtën e ka blerë dhe e ka pagua. Për shitblerjen e kësaj parcele nuk kemi lidhur kontratë të noteri por vetëm kontratë me dorë, mirëpo thekson se në atë kohe shitësi nuk i ka ofruar dokumente se është pronar i parcelës, shton se nga ajo kohë ka kontaktuar edhe me të dëmtuarat B. dhe J. J. i njëjti deklaroi se po kam kontaktuar se vinë shpesh të shpija dhe me kanë thënë se nuk ka problem hiç, “bile kur me kanë takuar mua me kanë thënë shpyr qe e ke marr ti këtë parcele”.

Nga mbrojtja e të pandehurit rezulton se i njëjti nuk e konteston faktin se e ka marr në posedim parcelën kontestuese edhe pse të njëjtën sipas tij asnjëherë nuk e ka punuar , mirëpo i njëjti shpjegon se këtë parcelë e ka blerë nga personi me emrin D. Mi..

Mbrojtja e të pandehurit përputhet në tersi me deklaratat e dëshmitarëve, sa i përket faktit vendimtar, përkatësisht faktit se ka qenë personi D. M. i cili e ka shitur këtë parcelë.

I pandehuri në shqyrtim gjyqësor në të gjitha fazat dhe në mbrojtjen e tij në mënyrë kategorike e mohon faktin se e ka uzurpuar parcelën kontestuese, i njëjti shpjegon se baza mbi të cilën e ka marr në posedim këtë parcele është blerja e të njëjtës nga D. M., e gjykata gjeti se ky pretendim mbështetet me deklaratat e dëshmitarëve M. J. dhe R. P..

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare mbeti në tersi pran akuzës, duke shprehur bindjen se me provat e administruara është arritur që të vërtetohet në tersi aktakuza dhe propozoj që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroj se për tokë i kam paguar parat dhe e kam ble, nuk jam fajtor për këtë vepër penale dhe nuk di çka me thonë tjetër.

e) Vlerësimi përfundimtar i gjykatës në lidhje me çështjen-Vëndimi në lidhje me fajsinë;

Gjykata duke u bazuar në nenin 7 dhe nenin 8 par.2 të KPPRK-së i vlerësoj provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, duke analizuar me vëmendje fuqinë e tyre provuese, duke vlerësuar nëse secila prove veç e veç dhe të gjitha së bashku do të vërtetonin faktet relevante – vendimtare për të cilat ngarkohet i pandehuri dhe nxori përfundimet si në vijim.

Është vërtetuar pa asnjë dyshim fakti që i pandehuri M. K. ka marrë në posedim parcelën P-...../3, gjë që nuk kontestohet as nga vetë i pandehuri.

Në këtë çështje penale nuk është vërtetuar fakti qëndrorë, fakti se i pandehuri e ka uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht e ka pushtuar pronën e të dëmtuarve pa pasur ndonjë pretendim pronësor.

Përkundrazi, gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua e kundërta e kësaj, se këtu i pandehuri e ka blerë parcelën kontestuese.

Kjo u vërtetua me anë të deklaratave të dëshmitarëve M. J. dhe R. P., të cilët dëshmojnë se ka qenë personi D. M. që e ka shitur parcelën kontestuese, e në anën tjetër përmes mbrojtjes së të pandehurit është vërtetuar se ka qenë ky i fundit i cili e ka blerë parcelën kontestuese.

Pra pa mëdyshje është vërtetuar fakti se i pandehuri M. K. e ka blerë parcelën kontestuese dhe se kjo ka qenë baza mbi të cilën i njëjti ka hyrë në posedim të kësaj parcele.

Për gjykatën në procedurë penale nuk është relevante fakti nëse kontrata e shitblerjes së paluajtshëmrisë i plotëson apo jo kushtet formale që kërkohen me Ligjin Për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendorë, me të cilat dispozita parashihen forma dhe mënyra e transferit të

pronësisë në sendin e paluajtshëm, pasi që kjo çështje mund të jetë objekt shqyrtimi në procedurë kontestimore dhe nuk ka karakter penal.

Në procedurë penale është me rëndësi aspekti subjektiv - përkatësisht fakti se i pandehuri në momentin e marrjes së posedimit në paluajtshemri a ka qenë i bindur se ka ndonjë bazë për marrjen e posedimit apo i njëjti duke e ditur se nuk ka kurrfarë bazë, me dashje e pushton paluajtshemrinë e tjetrit.

E në rastin e të pandehurit M. K., siç u tha edhe me lartë pa kurrëfarë mëdyshje është vërtetuar se i njëjti parcelën P-...../3 e ka futur në posedim në bazë të një kontrate të shitëblerjes.

Është me rëndësi të theksohet se edhe në vetë dispozitivin e aktakuzës, kur është bërë përshkrimi i veprimeve të kryerjës së vepres penale është theksuar se i pandehuri e ka blerë parcelen kontestuese, pra vetë prokuroria në aktakuzë ka bërë të qartë se i pandehuri parcelen kontestuese e ka marrë në posedim në bazë të kontratës së shitëblerjes.

Edhe pse prokuroria pretendon se kemi të bëjmë me shitëblerje me keqbesim, për gjykatën penale kjo nuk ka relevancë, pasi që edhe të metat e kontratës dhe anulimi eventual i sajë mund të shqyrohen në procedurë kontestimore, për gjykatën penale rëndësi ka fakti se si është marrë posedimi i paluajtshemrisë dhe me qafarë baze.

Si përfundim, nuk ka mëdyshje se me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor u vërtetua se vepra me të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale dhe se faktet e paraqitura si në aktakuzë përkatësisht dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm në procedurë kontestimore, andaj gjykata të kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPRK-së të pandehurin e liroj nga akuza.

f) Shpenzimet procedurës dhe kërkesa pasurore juridike;

Kur u vendos në lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata u bazua në nenin 453 par.1 të KPPRK-së, ku thuhet “Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve

të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga të dëmtuarit, siç parashihet nenin 457 par.1 të KPRK-së, si rrjedhojë gjykata nuk vendosi për kompensim të demit e as nuk e udhëzoi në kontest civil të dëmtuarin.

Andaj, duke u mbështetur në të thënat si me lartë dhe në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 dhe neni 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.162/17, me datë 20.11.2023

Procesmbajtësja:

Shpresa Kërnia

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.